

Aneks 1: Të dhëna statistikore të DPPPP për vitet 2013-2017

Referimet: Gjatë vitit 2017 janë referuar 401 raste në organet ligjzbatuese. Ndonëse në përgjithësi numri i referimeve ka rënie të lehtë (-2.4%), krahasuar me vitin 2016, vérehet rritje me +9.2% të rasteve të referuara në Prokurori.

Tabela 1: Rastet e referuara në organet e zbatimit të ligjit 2013-2017.


	2013	2014	2015	2016	2017
Referimet ne Prokurori	35	148	121	120	131
Referimet ne Polici	248	314	281	291	270
Total	283	462	402	411	401

Urdhrrat e bllokimit: Gjatë vitit 2017 janë nxjerrë 52 urdhra bllokimi të përkohshëm me vlerë totale 11.2 mln euro, nga të cilat janë sekuestruar rreth 9.1 mln euro. Ndonëse vlera e bllokimeve ka rënë krahasuar me një vit më parë, është rritur vlera e sekuestrimeve. Raporti i sekuestrimeve/bllokime rezultoi 80.8%, në nivelin më të lartë të 5-viteve të fundit.

Tabela 2: Të dhënat mbi urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet

Vitet	Nr. i urdhrave të bllokimit	Tot. bllokuar (euro)	Tot. sekuestruar (euro)	Raporti sekuestrime/bllokime
2013	15	881,670	213,500	24.2%
2014	65	18,183,760	13,967,770	76.8%
2015	47	16,278,080	11,266,941	69.2%
2016	61	28,772,733	8,129,000	28.3%
2017	52	11,263,587	9,096,233	80.8%

Grafik 1: Raporti bllokime/sekuestrime në vite



vepra penale të dyshuara: DPPP në rolin e Njësisë së Inteligjencës Financiare nisët nga funksionimi është e ndryshme nga agjencitë e tjera ligjbatuese, të cilat nisen nga hetimi i veprës penale për të arritur të paraja. Në shumicën e rasteve (60-70%) DPPP nuk arrin të eidentojë veprën penale të dyshuar si vepër mëmë për pastrimin e parave. Gjatë vitit 2017 numrin më të lartë të rasteve ku ka qenë e mundur të identifikohet vepra mëmë e zënë trafikimi lëndëve narkotike, evazioni fiskal dhe mashtrimet. Vërehet gjithë e rasteve të dyshuara për shpërdorim detyre ose korrupsion, të cilat shënuan numrin më të lartë, të paktën në 5-vitet e fundit.

Tabela 3: Referimet të ndara sipas dyshimit për veprën mëmë (në ato raste ku mund të eidentohet)

	2013	2014	2015	2016	2017
Trafikim të lëndëve narkotike	18	50	48	30	43
Trafikim i qëniveve njerëzore / shfrytëzim prostitucioni	4	9	6	7	2
Precedentë të mëparshëm kriminale	3	15	16	10	8
Krijim / Përfshirje në organizata kriminale	1	-	6	6	5
Financim terrorizmi	1	3	2	8	5
Mashtrim, mashtrim financiar, mashtrim kompjuterike	17 ¹	17	12	17	15
Falsifikim		3	8	2	5
Shpërdorim detyre apo korrupsion kryesisht pasiv	7	7	11	9	13
Mosdeklarim shumave dhe sendeve me vlerë në kufi	-	4	14	2	1
Dyshime për evazion fiskal	29	40	41	9	16
Vjedhje, grabitje, kanosje, pasojë vrasje	2	12	8	3	7
Trafikim i mjeteve motorike / shmangie detyrime doganore /Kontrabande	3	2	2	4	-
Pastrim parash kur kemi të bëjmë për persona me precedent të tillë apo dyshime për pastrim parash	2	-	4	2	9
Nuk dihet	196	300	224	302	272
Total	283	462	402	411	401

¹ Në vitin 2013 të dhënat mbi referimet për mashtrime mbaheshin së bashku me të dhënat për falsifikim

Indicia për rastet e dyshimta: Për sa i përket indicies, rezulton se për vitin 2017, burim kryesor i referimeve mbeten raportimet e aktivitetit të dyshimtë, kryesisht nga bankat. Nga 401 referime, 340 ose 85% e tyre e kanë indicien nga RAD, çka është tregues i efikasitetit të lartë të sistemit parandalues në vend.

Tabela 4: Indicia për referimet gjatë vitit 2017

	RAD	Analiza Sektoriale	RTPF	NJIF partnere	Njoftime ²	Total
Referimet ne Prokurori	105	8	3	1	14	131
Referimet ne Polici	235	7	10	2	16	270
Total	340	15	13	3	30	401

Verifikimet: Në përgjigje të kërkesave të organeve ligjzbatuese, gjatë vitit 2017, DPPPP ka kryer verifikime për 4,372 individë. Ndërkohë në kuadër të procesit të vetingut janë verifikuar dhe rreth 3,000 individë, duke çuar numrin e personave të verifikuar në 7,372, kundrejt mesatares vjetore prej 2,195 në periudhën 2013-2016. Pa konsideruar vetingun, numri më i lartë i verifikimeve është bërë për llogari të Policisë së Shtetit (2,497 individë), kurse pjesa tjetër për Prokurorinë (1,198) dhe ILDKPKI (677).


Grafik 2: Numri i kërkesave për verifikime dhe individët e përfshirë në to (pa vetingun)



² Në zërin njoftimet përfshihen edhe rastet e iniciuara nga burimet e hapura dhe të investiguara me iniciativën e DPPPP të cilat janë – në total, nga këto 6 në Prokurori.

Inspektimet: Gjatë vitit 2017 u inspektuan 171 subjekte, ku pjesa më e madhe e tyre (63%) ishin inspektime në distancë. 70% e inspektimeve janë përqendruar në subjektet me risk të lartë (banka, ZKV, lojëra fati, shoqëri ndërtimi, noterë) ndërkohë që pjesa e mbetur përfshijnë subjekte me risk të mesëm dhe të ulët. Fokus i veçantë është treguar në inspektimet në distancë të ekspertëve kontabël (12) dhe studiove ligjore (15).

Grafik 5: Numri i inspektimeve në vite



Masat administrative: Gjatë vitit 2017, janë aplikuar 26 masa administrative me vlerë totale 28.6 mln lekë. Peshën kryesore nga subjektet e gjobitura e zënë bankat ndaj të cilave janë aplikuar 5 masa me vlerë 17 mln lekë, të ndjekura nga shoqëritë e ndërtimit, ndaj të cilave u aplikuan 9 masa me vlerë totale 6 mln lekë. Në total, janë arkëtuar rreth 27.8 mln lekë.

Tabela 5: Të dhëna mbi masat administrative

	2013	2014	2015	2016	2017
Masa administrative	13	57	34	33	26
Vlera e masave (lekë)	15,900,000	28,530,000	34,700,000	30,100,000	28,600,000
Vlera e arkëtuar (lekë)	16,661,000	34,235,705	17,656,000	31,786,000	27,788,000

DPPPP, në rolin e institucionit drejtues dhe koordinues në këtë proces është angazhuar intensivisht duke bërë të gjitha përpjekjet për rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional, sensibilizimin për rëndësinë e procesit, këshillimin për procesin në tërësi, zhvillimin e takimeve me aktorë e faktorë kyç apo me influencë etj.

Raporti i vlerësimit për vendin tonë pritet të miratohet në seancën plenare të Komitetit Moneyval në javën e parë të muajit korrik të këtij viti.

I. Bashkëpunimi me organet e zbatimit të ligjit (Prokurori dhe Polici) dhe SHISH

Gjatë vitit 2017 ka vijuar komunikimi dhe bashkëpunimi me organet ligjzbatuese dhe ndonëse ka ende për të rregulluar, janë vërejtur elementë përmirësimi në disa aspekte që kanë të bëjnë me punën e DPPPP, kryesisht llojin e kërkesave që marrim nga këto organe, reagime për ecurinë e rasteve të iniciuara nga DPPPP etj.

Nga DPPPP gjatë vitit 2017:

- janë referuar gjithsej 401 raste (270 në Policinë e Shtetit dhe 131 në Prokurori), numër ky në total i qëndrueshëm krahasuar me vitet pararendëse;
- burim kryesor i referimeve mbeten raportimet e aktivitetit të dyshimtë, kryesisht nga bankat. 85% e referimeve e kanë indicien nga RAD, çka është tregues i efikasitetit të lartë të sistemit parandalues në vend.
- janë nxjerrë 52 urdhra bllokimi të përkohshëm² kryesisht për llogari bankare, për një vlerë totale prej rreth 11,2 milionë euro, prej të cilave janë sekuestruar me vendim Prokurorie/Gjykatë rreth 9 milionë euro;
- janë dërguar në SHISH një sërë rastesh për bashkëpunim të mëtejshëm.


DPPPP ka vijuar të bashkëpunojë ngushtë me Policinë e Shtetit. Vetëm në përgjigje të kërkesave të Policisë, gjatë vitit 2017, DPPPP ka verifikuar 2497 persona, ose 2-herë

¹ Seanca plenare e Komitetit Moneyval për miratimin e raportit do të zhvillohet në datat 2-6 korrik 2018, ndërsa në datat 20-22 mars do të zhvillohet një takim në rang ekspertësh në Strasburg me përfaqësues të vendit tonë dhe grupin e ekspertëve vlerësues.

² Me afat 72 orë

RAD: Numri i Raporteve të aktivitetit të dyshimtë ka ardhur vazhdimisht në rritje, duke shënuar nivelin maksimal historik (1,384). Kontributin kryesor e ka dhënë sistemi bankar, shoqëritë e tregtimit të mjeteve motorike dhe noterët. DPD ka ruajtur një trend të qëndrueshëm në vite, ndërkohë që DPT prej 3-vjetësh është në nivele minimale, ndonëse ka detyrim ligjor dërgimin e rasteve të dyshimta në DPPP.

Grafik 3: Numri i RAD në vite



Bashkëpunimi ndërkombëtar: Shkëmbimi i informacionit me homologët ka ardhur në rritje. Kërkesat e dërguara nga DPPP arritën në 74 kundrejt 42 një vit më parë dhe mesatares prej 50 kërkesash në vitet 2013-2016. Kërkesat e marra ishin 79, thuajse në të njëjtin nivel krahasuar me vitin 2016 dhe me rritje të lehtë kundrejt mesatares prej 68 kërkesash në vitet 2013-2016.

Grafik 4: Kërkesat për informacion të dërguara nga DPPP dhe Homologët

